



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 318/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerve të vendvotimit 1924/03d, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 318/2017 e datës 12.06.2017, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 12.06.2014, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017, në vendvotimin 1924/03d, është bërë gabim teknik ku votat e Lëvizjes Vetëvendosje janë bartur tek Partia Rome dhe se sipas vëzhguesve të tyre duhet të jenë 234 vota, ndërsa në FRP figurojnë vetëm 002 vota, kurse Partia Rome ka 234 vota. Parashtruesi i ankesave kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këtë qendër të votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar ende nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se rezultatet mund të ndryshojnë në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR, ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj, rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare dhe se në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtrojnë ankesë në afatin prej 24 orëve, pranë PZAP-së.

Bazuar në arsyet e lartë theksuara si dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 318/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.

